



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRËNDSHME

5548
Nr. _____ prot.

Divjakë, më 20.06.2025


**SHPALLJE PËR POZICIONET VAKANTE, NË PROJEKTIN “NGRITJA E SHËRBIMEVE
KOMUNITARE TË INTEGRUARA PËR FËMIJËT NË NEVOJË PËR VITIN 2025” BASHKIA
DIVJAKË**

Në zbatim të ligjit të ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, të ligjit 9355, datë 10.03.2005, “ Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, të ligjit nr.121/2016 “ Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të Marrëveshjes së bashkëpunimit nr.127/3 prot., 09.01.2025, nr.314 prot., datë 09.01.2025 ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Divjakë, “Për zbatimin e projektit” Shërbim komunitar për fëmijë në nevojë”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë nr.22, datë 24.04.2025 “Për miratimin e projektit “Ngritja e shërbimeve komunitare të integruara për fëmijët në nevojë” për vitin 2025, Bashkia Divjakë shpall konkurimin për vende të lira pune në pozicionet:

1. Drejtues projekti

Përshkrimi i përgjithshëm i vëndit të punës:

- Harton dhe ndjek planin e zbatimit të projektit, në përputhje me objektivat e përcaktuara në projekt.
- Koordinon dhe drejton stafin e projektit me qëllim, zbatimin e të gjitha aktiviteteve të projektit që synojnë përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve si dhe integrimin e fëmijëve në nevojë, në jetën shoqërore.
- Siguron ofrimin e shërbimeve të integruara psikosociale edukative, shëndetësore duke bashkëpunuar dhe me strukturat vendore të Bashkisë Divjakë.



Monitoron progresin e projektit dhe përgatit raportime periodike.

-Siguron respektimin e standarteve të mbrojtjes së fëmijëve dhe etikës profesionale në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.

KUSHTET DHE KRITERET

- Kandidati që aplikon duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë diplomë universitare në Shkenca Sociale, Menaxhim Projektesh, Shëndetësi, Edukim
4. Njohuri të mira mbi sistemin e shërbimeve sociale dhe mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve;
5. Të ketë të paktën mbi 5-vite eksperiencë pune;
6. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të projektit;
7. Të jetë i përkushtuar, i komunikueshëm për zbatimin e detyrave dhe udhëheqjes së stafit;
8. Të ketë aftësi për të hartuar raporte, përmbledhëse etj.
9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna;
10. Të ketë aftësi të punës në grup, aftësi gjyqësore;
11. Të ketë aftësi të mira të drejtimit dhe menaxhimit;
12. Preferohet të ketë punuar në këtë fushë.

-Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

2. Fizioterapist

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës:



- Të ofrojë vlerësim psikosocial, ndërhyrje dhe mbështetje terapeutike për fëmijët me nevoja zhvillimore, fizike, me qëllim përmirësimin e funksionit të tyre fizik.
- Kryen vlerësime funksionalefizike për fëmijët me paraliza cerebrale, sindroma të zhvillimit ose dëmtime fizike.
- Harton plane individuale fizioterapeutike të përshtatura me moshën dhe aftësitë e fëmijës.
- Zbaton terapi fizike individuale përmes ushtrimeve të specializuara, metodave të stimulimit, pajisjeve ndihmëse dhe lojërave terapeutike.
- Ndjek dhe dokumenton progresin e fëmijës dhe rishikon planin terapeutik në mënyrë periodike.
- Bashkëpunon me prindërit për tu dhënë udhëzime mbi ushtrimet që duhet të kryejnë fëmijët në shtëpi.
- Koordinon me psikologun, logopedin dhe punonjësin social për rastet me nevoja të kombinuara.

KUSHTET DHE KRITERET;

- Kandidati që aplikon duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë diplomë universitare Bachelor/ Master Fizioterapi; preferohet me specializim ose trajnim shtesë në pediatri/fizioterapi zhvillimore.
4. Të ketë qasje pozitive, etike, profesionale, ndjeshmëri ndaj fëmijëve në sistuata të vështira.
5. Liçenca Profesionale përbën avantazh;
6. Të ketë aftësi të mira për punë me fëmijët, empati dhe durim;
7. Të jetë i përkushtuar, i komunikueshëm për të punuar në ekip;
8. Të ketë aftësi për të përdorur pajisje fizioterapie dhe mjete ndihmëse duke ndjekur protokollet terapeutike.
9. Të ketë aftësi pune në grup.
9. Preferohet të ketë eksperiencë prej 2-vitesh, pune me fëmijë me nevojat të veçanta zhvillimore.

-Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune;
12. Fotokopje e Licencës;

13. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

3. Logopedist

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës:

- Kryen vlerësime individuale, diagnostikime dhe trajtime të çrregullimeve të komunikimit (dëmtimet e të folurit dhe gjuhës), çrregullimet njohëse të komunikimit, çrregullimet e zërit dhe çrregullimet e gëlltitjes.
- Harton plane individuale të ndërhyrjes logopedike në bashkëpunim me prindërit dhe me pjesën përbërëse të stafit;
- Zbaton terapi logopedike individuale dhe në grup, në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar;
- Monitoron progresin e fëmijës dhe përditëson planin e ndërhyrjes në përputhje me nevojat specifike;
- Respekton protokollet për mbrojtjen e fëmijëve dhe etikën profesionale në çdo ndërhyrje.
- Zbatimin e projektit me qëllim zhvillimin e aftësive komunikuese të fëmijëve në nevojë, duke kontribuar në përfshirjen e tyre të plotë në arsim, familje dhe shoqëri.
- Duhet të respektojë dhe të ruajë sekretin profesional në lidhje me çdo informacion që ka të bëjë me personat tek të cilët aplikohet trajtimi logopedik dhe nuk ka asnjë rast shmangie, përveç arsyeve serioze dhe të dokumentuara të natyrës sociale dhe/ose shëndetësore.


KUSHTET DHE KRITERET

- Kandidati që aplikon duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë diplomë universitare në Logopedi, Shkenca të Shëndetit; Master Profesional; Master Shkencor;
4. Të ketë eksperiencë praktike në vlerësimin dhe trajtimin e fëmijëve me çrregullime të komunikimit;
5. Liçenca Profesionale përbën avantazh;
6. Të ketë aftësi të mira për punë me fëmijët, empati dhe durim;
7. Të jetë i përkushtuar, i komunikueshëm për të punuar në ekip;
8. Të ketë njohuri për zhvillimin normal të gjuhës dhe çrregullimeve të zakonshme të komunikimit;
9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna;
10. Preferohet të ketë eksperiencë prej 2-vitesh.

-Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara;
4. Fotokopje të librezës së punës;

- 
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
 6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 7. Çertifikatë familjare;
 8. Vërtetim banimi;
 9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
 10. Fotokopje e Licencës;
 11. Çertifikata të kualifikimeve;
 12. Referenca pune.
 13. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

4. Psikolog

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës:

- Të ofrojë vlerësim psikosocial, ndërhyrje terapeutike dhe mbështetje emocionale për fëmijët në nevojë, duke kontribuar në mirëqënien mendore e zhvillimin e shëndetshëm të tyre.
- Harton raport vlerësimi dhe rekomandime për çdo fëmijë.
- Zbaton seanca terapeutike të rregullta e të dokumentuara, duke monitoruar progresin.
- Jep rekomandime e këshilla për prindërit e fëmijëve në nevojë, për të përforcuar përfshirjen prindërore, stresin dhe strategjitë e ndërhyrjes në shtëpi.
- Bashkëpunon me logoped, punonjës social për plane të përbashkëta ndërhyrjeje.
- Përpilon raporte periodike mbi rastet, progresin dhe sfidat sipas kërksave të projektit.
- Respekton plotësisht protokollet për mbrojtjen e fëmijës, konfidencialitetin dhe etikën profesionale.

KUSHTET DHE KRITERET

- Kandidati që aplikon duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë diplomë universitare Bachelor/ Master Psikologji Klinike; Psikologji Zhvillimi, Psikologji e Shëndetit;
4. Të ketë eksperiencë praktike në vlerësimin dhe trajtimin e fëmijëve me çrregullime të komunikimit;
5. Liçenca Profesionale përbën avantazh;
6. Të ketë aftësi të mira për punë me fëmijët, empati dhe durim;
7. Të jetë i përkushtuar, i komunikueshëm për të punuar në ekip;
8. Të ketë njohuri për të vlerësuar dhe kuptuar mendimet, emocionet dhe çrregullimet të zakonshme të komunikimit;
9. Preferohet të ketë eksperiencë prej 2-vitesh.



-Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune;
12. Fotokopje e Licencës;
13. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

5. Shofer

Përshkrimi i përgjithshëm i vëndit të punës:

- Ofron shërbimin e transportit për stafin e projektit dhe për përfituesit (fëmijët dhe familjarët që i shoqërojnë ata)
- Siguron lëvizjen e sigurt dhe në kohë drejt qëndrave të shërbimit, institucionit përkatës.
- Shoferi kujdeset për mirëmbajtjen teknike dhe pastrimin e automjetit, raportimin e çdo problem teknik dhe respektimin të rregullave të qarkullimit dhe protokolleve të sigurisë për fëmijët.


KUSHTET DHE KRITERET

- Kandidati që aplikon duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë diplomë të shkollës së mesme;
4. Të ketë leje drejtimi, kategoria B;
5. Të ketë të paktën mbi 5-vite eksperiencë pune si shofer;
6. Të ketë njohuri të mira të rregullave të qarkullimit rrugor;
7. Të jetë i përkushtuar, i komunikueshëm duke respektuar protokollat e mbrojtjes së fëmijëve në nevojë;
8. Të ketë njohuri të mira të rregullave të qarkullimit rrugor.

-Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;

- 
2. Jetëshkrimi (CV);
 3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
 4. Fotokopje të librezës së punës;
 5. Fotokopje të kartës së identitetit;
 6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 7. Çertifikatë familjare;
 8. Vërtetim banimi;
 9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 26. 06.2025 pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme.